

Udhëzues për kërkim të banesës apo dhomës për banim (*albanisch*)

Ky udhëzues që e keni para shërben si doracak. **Hollësishtëmërija e të dhënurave të Juaja është në bazë të lirë!**

1. Kërkoni banesë me listat e administratave dhe shoqatave tona për ndërtim

Formulari për regjistrim

Pranë këtijë udhëzuesi që e keni para, do të gjeni edhe adresat si dhe numrat e telefonave të administratave si dhe shoqatave tona ndërtimore. Ju këshillojmë që te sa më shumë **administrata sie dhe shoqata ndërtuese të kërkoni formularë për regjistrim**. Keni kujdesë që formularët të i mbushëni sa më mirë. Bashkë me formularin e mbushur për lajmërim, dosijesë për konkurim për banesë tek një shoqatë ndërtimore duhet të i bashkangjitni edhe këto dokumenta:

Dosijea për konkurim

- Kopjen e „Schriftenempfangsscheine“, /vërtetimit mbi dëshminë shtetësisë/, vlen vetëm për zvicërranë dhe zvicërrane
- Kopjet e letërnjoftimeve (për të huajë) / (Kopie der Ausländerurweise)
- Kopjen e Betreuungsauszuges (që mundë të mirret të zürja për Betreuung në qarkun e Juajë) (Kopie des Betreuungsauszuges)
- Kopjen e fletëpagesës së fundit të pagimit të tatimeve (Kopie der letzten Steuerrechnung)
- Kopjen e llogarisë së rrogës, apo të të marrunave nga kasa e të papunëve, apo të të marrunave nga arka e të siguruarve inavlid apo të sigurimit të pensionit apo të garancioneve të qirave (Kopie der Lohnabrechnung, Arbeitslosentaggelder-Abrechnung, IV - /AHV - Verfügung oder schriftliche Mietzinsgarantie).

Para se gjithashë, shoqatat ndërtimore kërkojnë nga Ju **të i dëshmoni të ardhurat e Juaja**. (Vendimet mbi saubvencionet - ndihmat në para). Gjithashtu edhe nëse merrni ndihma nga „Enti për të rinjë dhe ndihma sociale“ (këshillore sociale) keni shansa të mira të e gjeni një banesë, nëse nga punëtori- ja sozial-e gjegjëse e merrni një vërtetim- garancion qiraje, të cili e kopjoni dhe ia bashkangjitni kërkesës së Juajë.

Letrakonkuruese

Ju këshillojmë të e shkruani një letër konkuruese dhe këte tia bashkangjitni çdo formulari për paraqitje. Në këtë letër duhet të prezentoheni shkurtimisht (pra të i shkruani gjeneralitetet e Juaja), arësyt për kërkim të banesës si dhe kërkesat (dëshirat) e Juaja (madhësinë e banesës si dhe lartësinë e qirasë). Sipas mundësisë i shkruani edhe personat të cilët Ju preferojnë- të ashtuquajtur Referenzpersonen. „**Betreibungen**“ ndikojnë negativisht në konkurim të banesës, për këtë arsye nëse nuk jeni në „Betreibung“ e përmendeni këte pa tjetër.

Të vepruarit e mëtutjeshëm

Mundimet e Juaja për kërkesë të banesës i dokumentoni. Pas parashtrimit të kërkesës së Juajë tek administratat dhe shoqëritë ndërtimore, lajmërohuni në mënyrë permanente. Informohuni për konkurimin e Juajë, se kush është personi kompetent- përgjegjës për Ju si dhe si qëndrojnë shansat e Juaja. Pyetni në mënyrë të rregullt në periode kohore me telefon apo shkoni personalisht dhe informohuni direkt. Kështu do të jeni në kujtesë të parsonit i cili është përgjegjës dhe do të e dëshmoni interesimin e Juajë për gjetjen e banesës.



2. Kërkoni në gazeta ditore

Lexoni me mundësi sa më shumë gazeta sikurse janë ato ditore, pjesën „Immobilienteil“ „pasuritë e patundshme“ (këto gazeta ndahen për qdo ditë falas për familje në qytetin e Zürich-ut), gjithashtu lexoni në Tages-Anzeiger, në Der Limmattaler, Zürcher Oberländer und Unterländer, Zürichsee- Zeitung, Der Landbote, Sihltalzeitung, si dhe në gazeta të tjera të lagjeve. Është e ditur se në njoftimet - insertet e publikuara për banesa banesave të lira, shumë shpejt reagohej, sepse banesat e lira shumë shpejtë edhe nxihen.

3. Shfrytëzoni të gjitha mundësitë për të gjetur një banesë

Në rrethin tuajë:

Informojeni rrethin e miqëve dhe të afërmve të Juajë se po kërkoni banesë. Kërkoni ndihmë gjithsesi nga ta në bërjen e bisedave telefonike si dhe përpiqimin e letrave. Shfrytëzoni publikimet falas në panot informative në shtëpi të mallrave, shitore të lagjeve, qendra të ndryshme shoqërore dhe kulturore, shkolla si dhe spitale. Shfrytëzoni gjithashtu mundësitë në vendin e punës duke e informuar personelin, shërbimin inetrn social, udhëheqësit e Juajë si dhe kolegët e koleget e punës mbi kërkim të banesës. Ia vëni vëmendjen, kur të dilni për të shetituri, plakateve panove për informata para vendbanimeve, në dyerë të banesave - bloqeve, në të cilat gjinden banesat e lira. Gjithnjë e më shumë qiradhënës e praktikojnë këtë metodë.

Me mundësi, kontraten e banesës që e keni mos e anuloni vetë para se të e keni në duarë një kontratë të re të vlefshme.

Gjetja e një banese të përshtatshme mvaret nga shumë faktorë. Shansat e Juaja do të i rritni nëse Ju përmbaheni propozimeve tona. Kërkoni në mënyrë inetsive dhe shtjerrni të gjitha mundësitë e përmendura.

Ju dëshirojmë shumë sukses!